



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
Nr.07/351/01-233
Dt.20.03.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale e Komunës së Gjakovës**, për dhënen e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë, me destinim: Objekti i Qendrës Kryesore së Mjekësisë Familjare, me etazhitet B+P+2, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr 02/L-28 nenit 11, bien këtë:

AKTVENDIM

I. ILEJOHET: aplikuesit: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale e Komunës së Gjakovës, ndërtimi i objektit të kategorisë së dytë, me destinim - Objekti i Qendrës Kryesore së Mjekësisë Familjare, sipas Projektit Kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Rregullues Urban të rrugës "Mbretëresha Teutë" dhe Kushtet Ndërtimore të datës 25.06.2015, në ngastrën kadastrale ndërtimore me nr. 1167/2, ZK: Gjakovë - Qytet, në pronësi të PSH "Kuvendi i Komunës" Gjakovë, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objektit është B+P+2, në sipërfaqe të përgjithëshme (bruto) te objektit për këtë fazë: **S=1735.73 m²**

Bodrumi:	(Sip,Bruto):	S=395.75 m ²
Përdhesa:	(Sip,Bruto):	S=597.98 m ²
Kati i parë:	(Sip,Bruto):	S=395.75 m ²
Kati i dytë:	(Sip,Bruto):	S=346.25 m ²

II. Hartimin e projektit me destinim: ndërtimi i objektit të kategorisë së dytë me destinim – Objekti Social për persona eme nevoja të veqanta, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë "EngGroup"-SHPK-Prishtinë.

III. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkrar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

IV. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë për Punë Inspektuese, për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit të lokacionit të piketuar.
- Për Objektet e kategorisë së dytë, Investitori duhet që për secilën fazë të ndërtimit, të parashtojë kërkesë, pranë Drejtorisë për Punë Inspektuese, me qëllim të Inspektimit dhe përcjelljes së realizimit të punimeve nga secila fazë, si dhe kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm për lëshimin e Certifikatës - Lejes së Përdorimit të objektit.

V. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

Arsyetim

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komuna e Gjakovës, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM-së, me nr. 07/351/01-233, të datës 12.01.2017 për dhënjën e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë, me destinim - Objekti i Qendrës Kryesore së Mjekësisë Familjare, me etazhitet B+P+2, në ngastrën kadastrale ndërtimore me nr. 1167/2, ZK:Gjakovë - Qytet, siq është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 , të datës 09.03.2017, i vërtetuar nga DUMM-Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 13.01.2017, në pronësi të PSH"KUVENDI I KOMUNËS -GJAKOVË, lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Çertifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme(fotokopje) me nr.të lëndëve 90-17 dt.11.01.2017, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Kushtet Ndërtimore përr Rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit të qendërs së mjekësisë familjare, të datës 25.06.2015.
5. Lejen Mjedisore Komunale, me nr.07-351/02-2826, dt.24.02.2017, nga DUMM.
6. Raportin mbi punimet gjeomekanike hulumtuese dhe kërkimet laboratorike ne lokacionin e parashikuar per ndërtimin e qendra kryesore e mjekësisë familjare, me Investitor Komuna e Gjakoves.
7. Pëlqimin Sanitar me nr.14/530/01-2418, dt.08.02.2017, nga Inspektoriat Sanitar Komunal- Drejtoria e Inspeksionit e Komunës së Gjakovës.
8. Pëlqimin për lokacion nga mbrojtje kundër zjarrit, me nr.03/17, me datë 08.02.2017, lëshuar nga Sektori i parandalimit dhe hulumtimit të zjarrit - Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim e Komunës së Gjakovës.
9. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, dt. 10.02.2017.
10. Pëlqimin nga K.R.U."Radoniqi"Sh.A.-Gjakovë, të datës 30.01.2017.
11. Pëlqimin nga PTK –Vala, me nr.07, dt.30.01.2017.
12. Pëlqimin nga Ngrohtorja e Qytetit SH.A.me nr.091, dt.06.02.2017.
13. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, i punuar nga "EngGroup"-SHPK-Prishtinë.

I liruar nga taksa administrative, në bazë Nenit 5, paragrafi 5.15. nënparagrafi b), të Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa nga Shërbimet Komunale, me nr. 01 Nr.011-43964/2015, dt.30.-6.2015.


KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi,pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor në Prishtinë, dhe e njejta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspeksionit ,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arhivës.

Zyrtar i lartë për çështje juridike


Zenel Shabani,jur.dipl.


U.D. Drejtori


Elida Bejtullahu, inxh.e dipl.e ark.

K.K. GJAKOVË
Z.K. : Gj.Qytet
Ng. nr.1167-2

PLAN SITUACIONI

QENDRA KRYESORE E MJEKSISE FAMILJARE



Gjakovë,
09.03.2017

Punoi: Fatmir Bobi tek.

Kontrollloi: Durrije Berisha I.D.A.

P=1:500



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVES / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT \ KOPJA PLANA \ COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija \ Municipal Cadastral Office : GJAKOVË
Zona Kadastrale / Katastarska Zona \ Cadastral Zone : Gjakovë Qytet

Njësia \ Jedinica \ Unit	Tipi \ Vrisa \ Type	Sipërfaqja \ Poveršina \ Area m²
P - 70705029 - 01167 - I	Parcela \ Parcela \ Parcel	4564.0 ±

